



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 2770 Prot.

Patos, më 12/09/2025

**MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro**

PROJEKTVENDIM
Nr. 53, datë 12/09/2025

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË FONDIT MIDIS PROGRAMEVE
“ARSIMI BAZË” NË PROGRAMIN “FURNIZIMI ME UJË” PËR OBJEKTIN
“SHTIM RRJETI KUZ NË BLOKUN VRESHT, LAGJJA E RE”**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 83, datë 27.11.2024 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, dhe buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2025”. Drejtuesit e programit të Arsimit Bazë dhe Furnizimit me ujë, pasi analizuan buxhetin e 8-mujorit rezultojnë se ka çlirim fondi në objektin “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”, për këtë arsye:

KËRKOJMË:

1. Të miratojë shtesën e fondit në programin “Furnizimi me ujë” me kod programi 06370 për objektin “Shtim rrjeti kuz në bllokun Vresht, lagjja e Re” (bazë materiale) në vlerën 1,994,220 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet) lekë.
2. Të miratojë pakësimin e fondit në programin “Arsimi bazë” me kod programi 09120 për mbulimin e kostos e këtij objekti në vlerën 1,994,220 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet) lekë, e cila do të mbulohej nga çlirimi i fondit nga objekti “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”, në programin “Arsimi Bazë”.

Struktura buxhetore për këtë objekt është:

- Shtesë Grupi 00, kapitulli 5, programi 60370, kod projekti 1120070, me vlerë 1,994,220 lekë.
- Pakësim Grupi 00, kapitulli 5, programi 09120, kod projekti 1120157, me vlerë 1,994,220 lekë.

Drejtuesi i Programit

Furnizimi me ujë

Dr. Projekte dhe E.C

Ermenita Mici

Drejtuesi i Programit

Arsimi Bazë

Dr. Arsimi

Mitjon Nikolla

Dr. Finance

Mimoza Shtëmbari

JURISTE

Nurkë Hazizaj

Dr. Planifikimi Urban

Boreta Murati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 2779 Prot.

Patos, më 12/09 /2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË FONDIT MIDIS PROGRAMEVE
“ARSIMI BAZË” NË PROGRAMIN “FURNIZIMI ME UJË” PËR OBJEKTIN
“SHTIM RRJETI KUZ NË BLOKUN VRESHT, LAGJJA E RE”**

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar rikonstruksioni i segmenteve në bllokun Vresht, lagjja e Re, ku është menduar ndërhyrja në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotur në disa segmente, duke përjashtuar disa segmente të tjera.

Po ashtu, si pasojë e ndërhyrjes në paketën e shtresave rrugore të këtyre segmenteve është dëmtuar rrjeti i kanalizimeve ekzistues të banorëve me tubo pvc 100mm. Për këto arsye kërkohet që të ndërhyhet në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në disa segmente të paparashikuara në projekt. Ndërhyrja në këto segmente kërkon shtesë fondi pasi duke marrë parasysh koston e punimeve të ndërtimit është menduar të blihet bazë materiale dhe punimet do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Pasi drejtuesit e programeve “Arsimi Bazë” dhe “Furnizimi me ujë” analizuan buxhetin e 8-mujorit rezulton se ka çlirim fondi në objektin “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos” midis vlerës së parashikuar në buxhet dhe vlerës së kontratës së fituar e cila mbulon plotësisht këtë vlerë. Për arsyet e sipërpërmendura i kërkojmë Këshillit Bashkiak:

1. Të miratojë shtesën e fondit në programin “Furnizimi me ujë” me kod programi 06370 për objektin “Shtim rrjeti kuz në bllokun Vresht, lagjja e Re” (bazë materiale) në vlerën 1,994,220 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet) lekë me tvsh.
2. Të miratojë pakësimin e fondit në programin “Arsimi bazë” me kod programi 09120 për mbulimin e koston e këtij objekti në vlerën 1,994,220 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet) lekë me tvsh, e cila do të mbulohet nga çlirimi i fondit të objektit “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”, në programin “Arsimi Bazë”.

Struktura buxhetore për këtë objekt është:

- Shtesë Grupi 00, kapitulli 5, programi 60370, kod projekti 1120070, me vlerë 1,994,220 lekë.
 - Pakësim Grupi 00, kapitulli 5, programi 09120, kod projekti 1120157, me vlerë 1,994,220 lekë.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Planifikimit Urban, Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Njësia e Prokurimit.

Ekipi Menaxhimit të programit “Arsimi Bazë”

Drejtues Programi
Mitjon Nikolla

Antarët:

Fatjona Xoxi



Miranda Mete



Manushaqe Lamaj



Burbuqe Nexha



Ekipi Menaxhimit të programit “Furnizimi me ujë”

Drejtues Programi

Ermenita Mici



Silvana Mici



Mario Tupa




Orges Mara

Boreta Murati



KRYETAR

Fatjon Duro



REPUBLICA E SHQIPËRIE
BASHKIA E PATOS